

## **RELACION SHPJEGUES**

### **I PROJEKTLIGJIT “PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË”**

#### **I. Qëllimi i projektligjit dhe objektivat që synohen të arrihen**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i bazave juridike për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të reformimit të saj, si një institucion i rëndësishëm me ndikim në thellimin e reformave për kërkimin shkencor në vend.

Objektivat e projektligjit kanë të bëjnë me ndërtimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave në përshtatje me nevojat e zhvillimit të vendit si edhe nevojën e rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore e praktike dhe integritetit të kërkimit shkencor.

#### **II. Argumentimi i projektligjit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme**

Ky projektligj është hartuar në përgjigje të kërkesave të drejta të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, por edhe të komunitetit akademik e shkencor të vendit si dhe interesit publik për të ndërtuar një Akademi të Shkencave sipas modeleve më të suksesshme bashkëkohore, konform standardeve të ALLEA-s (All European Academies).

Projekti ridimensionon dhe ripërcakton funksionet e Akademisë së Shkencave, duke theksuar rolin këshillimor, rekomandues, promovues, botues, nxitës, bashkëpunues dhe bashkërendues të saj në sistemin e kërkimit shkencor të vendit.

Projektligji synon dhe pritet të realizojë ripërtëritjen e Akademisë së Shkencave dhe të përbërjes së saj me përfaqësues nga më të shquarit të komuniteteve shkencore të vendit, nëpërmjet harmonizimit të brezave, moshave e fushave të kërkimit.

Për këtë qëllim, projektligji vendos kritere më rigorozë e të matshme për pranimin e anëtarëve të rinj si edhe vendos si kufi pranimi për anëtarët e rinj të Akademisë moshën 65 vjeç, duke përfshirë edhe institucionet e arsimit të lartë e të kërkimit në përzgjedhjen e kandidatëve.

Gjithashtu, projektligji nuk përfshin më kategorinë e akademikut të përhershëm, duke iu dhënë akademikëve mbi 75 vjeç statusin Emeritus, duke i çliruar ata nga disa detyrime institucionale të pjesëmarrjes në veprimtarinë e Akademisë, çka mundëson krijimin e vendeve të lira për rifreskimin e Akademisë me anëtarë të rinj.

Projektligji krijon një hapësirë të re për përfshirjen si anëtarë të jashtëm të gjithkujt, me origjinë shqiptare, që ka një aktivitet të dallueshëm jashtë vendit e sidomos ndaj gjithkujt që ka fituar titullin "akademik" nga një akademi simotër.

Projektligji parashikon funksionimin e Akademisë së të Rinjve, si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë së Shkencave, me synimin për të inkurajuar drejtpërsëdrejti veprimtarinë kërkimore shkencore të kërkuesve të rinj dhe për vendosjen e një ure komunikimi e promovimi me ta.

Projektligji krijon kushtet ligjore për demokratizimin e funksionimit të Akademisë së Shkencave, duke harmonizuar vendimmarrjen e organeve ekzekutive më atë të Asamblesë dhe seksioneve, si edhe duke përcaktuar qartë kompetencat, funksionet dhe procedurat vendimmarrëse. Projektligji kufizon mandatet e drejtuesve të zgjedhur të Akademisë deri në dy, duke krijuar kushtet për ripërtëritjen edhe të drejtuesve të Akademisë.

Projektligji synon të ndërtojë një Akademi të Shkencave të hapur drejt komuniteteve të arsimit të lartë dhe atyre kërkimore të vendit. Kjo do të realizohet nëpërmjet ndërtimit të komisioneve, si njësi permanente të Akademisë, në kuadrin e seksioneve, dhe të përbëra, përveç se nga anëtarët e Akademisë, edhe nga profesorë dhe ekspertë të kualifikuar të të gjitha fushave dhe me arritje të spikatura në disiplinat përkatëse. Qendra e gravitetit të veprimtarisë së Akademisë zhvendoset nga Kryesia, drejt Asamblesë, seksioneve e komisioneve.

Projektligji përcakton dispozita ligjore për garantimin e integritetit të kërkimit shkencor në Shqipëri, jo vetëm në kuadrin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave dhe anëtarëve të saj, por për të gjithë sistemin e kërkimit shkencor dhe të institucioneve të arsimit të lartë në vend.

Kjo realizohet në sinergjinë e këtij projektligji me projektligjin tjetër që po paraqitet për miratim paralel me të, “Kodi i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, i cili përmban parimet dhe normat themelore të sjelljes së institucioneve akademike e kërkimore dhe punonjësve akademikë e kërkuesve shkencorë në Republikën e Shqipërisë. Akademia e Shkencave propozohet të jetë mjedisi institucional ku do të funksionojë Kolegji i Etikës, si instanca më e lartë e shqyrtimit të ankimeve dhe vendosjes së sanksioneve për shkeljet e integritetit të kërkimit shkencor.

Gjithashtu, integriteti i Akademisë dhe i akademikëve garantohet edhe nga përcaktimet ligjore të qarta mbi vlefshmërinë, papajtueshmëritë dhe ndërprerjen e mandateve të akademikëve e drejtuesve të Akademisë.

Projektligji krijon kushtet ligjore që funksionimi i Akademisë së Shkencave dhe veprimtaria e saj të hapen e sinkronizohen me veprimtarinë e Akademive dhe akademikëve shqiptarë jashtë Shqipërisë. Një dispozitë e veçantë e tij parashikon që personat me shtetësi shqiptare që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të ALLEA-s, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kjo dispozitë do të mundësojë sinergjinë midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtarëve të saj me akademikët shqiptarë në vendet e rajonit dhe në Diasporë, për trajtimin në mënyrë më të institucionalizuar e më të koordinuar të problematikave shkencore mbarëkombëtare.

### **III. Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin**

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, posaçërisht nenin 58, i cili garanton se liria e kërkimit shkencor mbrohet me ligj, dhe nenin 59, i cili përcakton se shteti synon mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Projektligji është në përputhje të plotë si dhe me të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi, përfshirë nevojën e përputhshmërisë dhe harmonizimin teknik me projektligjin për shkencën dhe për arsimin e lartë, për të cilat do të bëhen ndryshimet përkatëse.

Projektligji është në sinergji e sintoni me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë, ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, projektligjin “Kodi i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, i cili paraqitet për miratim së bashku me këtë projektligj, ligjin për shkencën, si edhe legjislacionin për kërkimin shkencor në proces përgatitjeje.

#### **IV. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me *acquis communautaire***

Projektligji reflekton standardet dhe praktikat më të mira europiane, si dhe parimet e veprimtarisë shkencore evropiane, çka konfirmohet qartazi nga vlerësimi i ALLEA-s bashkëngjitur.

Projektligji është në përputhje të plotë me standartet ALLEA-All European Academies (Shoqata e Akademive Europiane), në të cilën është anëtare edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Projektligji është në përputhje edhe me kërkesat e Kodit Europian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, 2017.

#### **V. Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektligjit**

Kreu i Parë titullohet “**Dispozita të përgjithshme**” dhe përmban përcaktimet ligjore mbi qëllimin, objektin dhe përkufizimin e Akademisë së Shkencave si institucioni publik përfaqësues më i lartë i shkencës e i kërkimit shkencor në vend; që vepron përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh; si një institucion autonom në fushën e kërkimit; që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit;

Në këtë kre përcaktohet përbërja dhe roli e funksionet kryesore të Akademisë, si përbërja e pranimit i krijuesve e kërkuesve të shquar; kontributi në promovimin e arritjeve të kërkimit shkencor dhe propozimin e fushave të reja kërkimore në përputhje me përparësitë e nevojat e zhvillimit të vendit; këshillimi e ndihma me rekomandime, ekspertiza e opoenca për qeverinë e institucionet qendrore; përgatitja e promovimi i shkencëtarëve të rinj, botimet cilësore periodike; bashkëpunimi me institucionet e vendit me kapacitet kërkimi, si institucionet e arsimit të lartë, institutet dhe qendrat e kërkimit, me qëllim koordinimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e kërkuesve të rinj; bashkëpunimi me institucionet analoge jashtë vendit për promovimin e arritjeve e për tërheqjen e projekteve të përbashkëta, për diplomacinë shkencore dhe për të përfaqësuar në shkallë ndërkombëtare komunitetin shkencor shqiptar etj.

Kreu i Dytë titullohet “**Përbërja e detyrat e Asamblesë**” dhe përcakton se Asambleja përbëhet nga akademikët dhe akademikët e asociuar, dhe numri i akademikëve është deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar është deri në 10; përcakton kërkesat e standardet e larta shkencore e profesionale për zgjedhjen e anëtarëve të Asamblesë, duke përcaktuar se në

procedurat e kandidimit e të përzgjedhjes përfshihen edhe struktura a përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor e të kulturës.

Ky kre përcakton se Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personalitetet shkencore me shtetësi a origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas joshqiptarë, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri.

Kreu përcakton gjithashtu se personat me shtetësi shqiptare që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të ALLEA-s, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Kreu bën përcakton e anëtarëve të Asamblesë që mbushin moshën 75 vjeç, si anëtarë "emeritus".

Kreu i dytë përcakton edhe detyrat e Asamblesë, si zgjedhja e anëtarëve të Akademisë; zgjedhja e Kryesisë (Kryetarin, nënkryetarin, sekretarin shkencor, drejtuesit e seksioneve); miratimi i projektbuxhetit vjetor, i programit të punës dhe raportit vjetor të punës si edhe i programeve afatgjata e strategjive të zhvillimit; miratimi i Statutit, i çmimeve kombëtare etj.

Në këtë kre përcaktohen edhe të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Asamblesë, si dhënia e ekspertizës e këshillimeve për institucionet shtetërore e ato publike të shkencës e të arsimit; pjesëmarrja në këshillat shkencorë e në senatet e institucioneve publike të arsimit të lartë a në institute ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre, si anëtarë *ex officio*, pjesëmarrja në njësitë a grupet e punës për studimin, hartimin a kërkimin në fusha të caktuara etj.

Kreu i tretë titullohet **“Organet ekzekutive”** dhe përcakton përbërjen dhe kompetencat e kryesisë, kufizon mandatat e anëtareve të kryesisë deri në dy mandate, përcakton kompetencat e Kryetarit të Akademisë, si drejtimi e organizimi i punës e veprimtarisë së Akademisë e të Kryesisë; përfaqësimi i Akademisë në marrëdhënie me të tretët; raportimi në Asamble; drejtimi i mbledhjeve të Asamblesë etj.

Kreu i katërt titullohet **“Vlefshmëria, papajtueshmëritë dhe ndërprerja e mandateve”** dhe përcakton se titujt "akademik" dhe "akademik i asociuar" janë tituj shkencorë, e si të tillë hiqen vetëm në rastet e parashikuara në këtë ligj a me vendim gjykate, dhe shoqërohen me një pagesë shtesë të përcaktuar me VKM; kur një anëtar i Asamblesë shkon me banim të përhershëm jashtë vendit, atëherë ai kalon në statusin "anëtar i jashtëm" dhe në rast rikthimi, rifiton statusin e mëparshëm; nuk mund të zgjidhen anëtarë të Asamblesë personat mbi 65 vjeç dhe as personat që ushtrojnë funksionin e drejtuesit në institucionet kushtetuese e në partitë politike; nuk mund të zgjidhen në organet drejtuese personat që kanë detyra të larta drejtuese në partitë politike etj.

Në këtë kre përcaktohen edhe kushtet e ndërprerjes së mandatit të akademikut, si kur jep dorëheqjen dhe për komprometim të rëndë të figurës së akademikut, për shkelje të "Kodit të etikës së kërkimit shkencor" a për shkaqe të parashikuara në ligj me vendim të Asamblesë, të marrë me shumicë absolute.

Parashikohen gjithashtu edhe kushtet e ndërprerjes së mandatit të anëtarit të kryesisë për shkaqet e mëposhtme, si kur jep dorëheqjen, për komprometim të rëndë të figurës së akademikut, për shkelje të "Kodit të etikës së kërkimit shkencor" a për shkaqe të parashikuara në ligj; kur pranon të zgjidhet a emërohet në një funksion të papajtueshëm të parashikuar në këtë ligj, kur mbush

moshën 75 vjeç ose kur shkarkohet nga Asambleja me 2/3 e votave, për shkelje të rënda në ushtrimin e detyrës.

Kreu i pestë titullohet **“Strukturat e njësitë ndihmuese”** dhe përcakton strukturat ndihmëse të Akademisë si seksionet, komisionet, njësitë e kërkim-studimit dhe Akademia e të Rinjve

Kreu i gjashtë titullohet **“Dispozita të fundit”** dhe përcakton marrëdhëniet e Akademisë me institucionet shtetërore, duke nënvizuar se Akademia ia përcjell raportin vjetor Këshillit të Ministrave e ministrisë përgjegjëse për Shkencën dhe Komisionit Parlamentar përkatës; Akademia përfaqësohet me të drejta të barabarta në të gjitha organet në nivel kombëtar të parashikuara të ligji për shkencën nga persona të autorizuar prej saj; si edhe organizimin një herë në vit të dialogut Akademi – Qeveri, sipas një marrëveshjeje dypalëshe.

Në këtë kre përcaktohet se Kryesia e Akademisë, në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe për kryerjen e shërbimeve administrative, profesionale e teknike, mbështetet nga administrata e Akademisë dhe se Sekretari shkencor kryen edhe funksionet e sekretarit të përgjithshëm; struktura, organika dhe niveli i pagave përcaktohen nga Asambleja me propozim të Kryesisë në përputhje me kriteret dhe nivelet e përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Kreu përcakton gjithashtu se Akademia është një institucion buxhetor dhe se veprimtaria e saj financohet nga buxheti i shtetit; shërbimet tekniko-shkencore që kryen për persona; juridikë e fizikë jashtë sistemit të saj; aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

## **VI. Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e ligjit**

Projektligji ngarkon për zbatimin e tij Këshillin e Ministrave, ministrinë përgjegjëse për shkencën, ministrinë përgjegjëse për financat, Akademinë e Shkencave, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore, organizatat dhe shoqatat e dijes, si dhe kërkuesit që kryejnë kërkim publik e privat, organet e tjera të lidhura me veprimtarinë akademike e kërkimore të cilët zhvillojnë dhe mbajnë përgjegjësitë e veta në procesin e kërkimit shkencor.

## **VII. Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektligjit**

Projektligji u hartua nga grupi i punës i ngritur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe nga komisioni *ad hoc* i ngritur nga Asambleja e Akademisë së Shkencave.

Projektligji iu nënshtrua një procesi konsultimesh me akademikë, përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë, qendrave dhe instituteve kërkimore, shoqërisë civile, sektorit privat etj.

Projektligji u diskutua dhe u miratua në parim dhe nën për nen edhe me drejtues dhe përfaqësues të ALLEA-All European Academies (Shoqata e Akademive Europiane), si edhe Akademisë së Gjermanisë “Leopoldina”.

Grupi i punës i ngritur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe komisioni *ad hoc* i ngritur nga Asambleja e Akademisë së Shkencave ia përcollën këtë ligj deputetëve nënshkrues të kësaj nisme ligjvënëse. Pas diskutimeve të përbashkëta midis grupeve të punës dhe deputetëve, vendosëm paraqitjen për shqyrtim dhe miratim në Kuvend të kësaj nisme ligjore.

#### **VIII. Shpenzimet buxhetore që lidhen me miratimin e projektligjit**

Projektligji nuk sjell si pasojë rritje të shpenzimeve buxhetore për Akademinë e Shkencave, as për institucione të tjera.